

1 E martë, 10 nëntor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Veseli hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve brenda
7 dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Përpara se të fillojmë dhe në përputhje me vendimin për
9 caktimin e datës së kësaj Paraqitjeje të Parë, fotografit i
10 lejohet që të bëjë disa fotografi për një minutë e gjysmë. Do
11 të kërkoja nga fotografi që të mos bëjë fotografi të të
12 akuzuarit me rojat e sigurisë në sfond. Ju faleminderit.

13 Ju faleminderit.

14 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Lënda KSC-BC-2020-06,
16 Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
17 Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit znj.

19 Sekretare.

20 Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve që të prezantohen,
21 dua t'i kujtoj të gjithë për disa rregulla që duhet të
22 respektohen gjatë gjithë kohës në mënyrë që kjo seancë të
23 zhvillohet pa pengesa.

24 Ju lutem ndizni mikrofonin përpara se të flisni dhe
25 fikenit posa të përfundoni me të folurit. Flisni ngadalë dhe

1 qartë, duke qenë se ajo që thuhet përkthehet në gjuhën shqipe
2 dhe serbishte dhe prej këtyre gjuhëve.

3 Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua, apo
4 një pale ose pjesëmarrësi, në mënyrë që përkthyesit të kenë
5 kohë të përfundojnë përkthimin.

6 Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptohet në kohë reale
7 dhe do të zbardhet në një transkript, i cili do t'u vihet në
8 dispozicion publikut dhe palëve pas kësaj seance.

9 Gjithashtu, dua t'i kujtoj palët se një pjesë e
10 informacionit në këtë çështje është objekt i masave mbrojtëse
11 dhe urdhrave për konfidencialitet. Këtu përfshihet
12 informacioni konfidencial që është redaktuar nga Aktakuza e
13 Konfirmuar, përkatësisht, informacioni në lidhje me
14 identitetin e disa individëve, me data, vende, dhe informacion
15 tjetër konfidencial.

16 Informacioni konfidencial nuk nxirret në seancë të hapur.
17 Në qoftë se një palë apo pjesëmarrës do të kalojë në seancë
18 private për t'iu referuar një informacioni konfidencial, për
19 këtë duhet të paraqesë arsyet.

20 Tani do t'u kërkoja palëve dhe pjesëmarrësve që të
21 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të
22 Specializuar.

23 Urdhëroni z. Prokuror.

24 Z. TIEGER: [Përkthim] Ju faleminderit. Mirëdita të
25 gjithëve të pranishëm në sallë dhe atyre që na ndjekin nga

1 jashtë në emër të Zyrës së Prokurorisë Speciale.

2 Sot të pranishëm janë Prokurori i Specializuar, Jack
3 Smith; Zëvendësprokurori i Specializuar Alex Whiting; shefja e
4 Njësisë për Çështje Juridike Clare Lawson; prokurori David
5 Harbach; dhe unë Prokuror i Lartë, Alan Tieger.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuror.

7 Tani radhën e ka Mbrojtja.

8 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] Në emër të
9 Kadri Veselit, ai përfaqësohet sot nga unë Ben Emmerson dhe
10 ndihmësi im Andrew Caley, i cili është i pranishëm aty në
11 sallë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.

13 Emmerson. Në qoftë se gjatë kësaj seance keni ndonjë problem
14 apo pengesë me lidhjen, ju lutem të na e bëni këtë të ditur sa
15 më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që ta rregullojmë
16 problemin, dhe në qoftë se ndërpritet komunikimi, atëherë mund
17 të bëjmë edhe pushim të seancës.

18 Për hir të procesverbalit theksoj se i pranishëm në sallë
19 është edhe klienti juaj z. Veseli.

20 Tani ia jap fjalën Administratorit.

21 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.
22 Fidelma Donlon, Administratore.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

24 Administratore.

25 Për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i

1 Procedurës Paraprake në këtë çështje.

2 I akuzuari sot paraqitet për herë të parë para Dhomave të
3 Specializuara pas Aktakuzës së Konfirmuar kundër tij.

4 Z. Veseli, ju lutem ngrihuni në këmbë. A mund, ju lutem,
5 të na e thoni emrin dhe mbiemrin?

6 I AKUZUARI VESELI: Pra, z. Gjykatës, unë jam Kadri
7 Veseli. Kam lindur më 31 maj 1967 në Mitrovicë, shteti i
8 Kosovës.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cila është shtetësia juaj?

10 I AKUZUARI VESELI: Republika e Kosovës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Veseli.
12 Mund të uleni.

13 Tani do të kaloj te historia procedurale e kësaj
14 çështjeje.

15 Më datën 26 tetor 2020, unë si Gjykatës i Procedurës
16 Paraprake konfirmova Aktakuzën që parashtroi Prokurori i
17 Specializuar kundër të akuzuarit që përmbahen gjashtë akuza
18 për krime kundër njerëzimit, përkatësisht, për përndjekje,
19 burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, dhe
20 zhdukje me forcë e personave; dhe katër akuza për krime lufte,
21 përkatësisht, ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe
22 vrasje e paligjshme.

23 I akuzuari u arrestua në Kosovë më 5 nëntor 2020 dhe u
24 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
25 Specializuara të Kosovës në Hagë po atë ditë.

1 Z. Veseli, përpara se të vazhdojmë dua të sigurohem se
2 mund ta ndiqni procedurën në një gjuhë që e kuptoni dhe
3 flisni. A mund, ju lutem, të më konfirmoni se e kuptoni dhe e
4 flisni gjuhën shqipe?

5 I AKUZUARI VESELI: Po i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Veseli. Me
7 konfirmimin tuaj jam bindur se mund ta ndiqni procedurën në
8 gjuhën shqipe si gjuhë që e kuptoni dhe e flisni, në përputhje
9 me rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

10 Në qoftë se gjatë procedurës së sotme nuk e dëgjoni
11 përkthimin apo ka ndonjë problem në përkthim, atëherë ju lutem
12 të ma bëni këtë me dije menjëherë.

13 Tani më lejoni ta shpjegoj qëllimin konkret të seancës së
14 Paraqitjes së Parë për nevojat e të të akuzuarit dhe atyre që
15 na ndjekin nga galeria e publikut dhe online.

16 Sot -- seanca e sotme, pra, nuk është gjykim. Nuk do të
17 paraqiten dhe as të debatohen prova. Fajësia ose pafajësia e
18 të akuzuarit nuk do të diskutohet, dhe në lidhje me të nuk do
19 të merret vendim në këtë seancë. Qëllimi i Paraqitjes së Parë
20 rregullohet me nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të
21 Rregullores.

22 Sipas këtyre dispozitave, unë si Gjykatës i Procedurës
23 Paraprake duhet:

24 t'ia lexoj të akuzuarit akuzat e paraqitura në Aktakuzën
25 e Konfirmuar në një gjuhë që ai e kupton dhe flet;

1 të konfirmoj se i akuzuari e kupton Aktakuzën;
2 të bindem se të drejtat e të akuzuarit, dhe sidomos e
3 drejta e tij për të pasur mbrojtës, janë respektuar;
4 ta informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita e
5 sotme, ai do të ftohet për t'u vetëdeklaruar lidhur me
6 fajësinë ose pafajësinë për secilën pikë të paraqitur në
7 Aktakuzë. Në qoftë se i akuzuari dëshiron, ai mund ta bëjë
8 këtë menjëherë. Pra, të vetëdeklarohet lidhur me fajësinë ose
9 pafajësinë.

10 Së fundi, gjatë kësaj seance do të caktoj dhe data të
11 tjera, sipas nevojës, në kryerjen e detyrave të mia si
12 Gjykatës i Procedurës Paraprake.

13 Pres palët që t'u përmbahen këtyre çështjeve të cilat do
14 t'i trajtojmë një nga një. Në qoftë se ndonjëra prej palëve
15 dëshiron të diskutojë ndonjë çështje që nuk është paraparë në
16 kuadër të kësaj Paraqitjeje të Parë, i ftoj që këtë ta bëjnë
17 me shkrim, pra, duke më dorëzuar parashtrime me shkrim.

18 Z. Veseli, së pari dua t'ju pyes, ose t'ju kërkoj të më
19 konfirmoni se e keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar të datës 4
20 nëntor 2020 në një gjuhë që e flisni dhe e kuptoni?

21 I AKUZUARI VESELI: Po.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Veseli.

23 Tani do t'i kërkoj Sekretares, ose Sekretarit që t'i
24 lexojë akuzat nga Aktakuza e Konfirmuar siç parashihet në
25 nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim]

2 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar
3 akuzon z. Kadri Veseli për:

4 Pika 1: Përndjekje, si krim kundër njerëzimit i
5 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

6 Pika 2: Burgosje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm
7 në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

8 Pika 3: Ndalim arbitrar, krim lufte i ndëshkueshëm në
9 bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

10 Pika 4: Akte të tjera çnjerëzore, si krim kundër
11 njerëzimit i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

12 Pika 5: Trajtim mizor, krim lufte i ndëshkueshëm në bazë
13 të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

14 Pika 6: Torturë, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm në
15 bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

16 Pika 7: Torturë, si krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të
17 nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

18 Pika 8: Vrasje, krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm në
19 bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

20 Pika 9: Vrasje e paligjshme, krim lufte i ndëshkueshëm në
21 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe

22 Pika 10: Zhdukje me forcë e personave, krim kundër
23 njerëzimit i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të Ligjit.

24 2. Këto krime u kryen midis afërsisht prillit 1998 dhe
25 gushtit 1999, në një numër vendesh në Kosovë dhe në Shqipërinë

1 veriore, ndër të cilat:

2 a. Bare, Bajgorë, Llapashticë, Majac, Potok dhe vende të
3 tjera në komunën e Podujevës; Drenoc dhe vende të tjera në
4 komunën e Rahovecit; Malet e Berishës, Llapushnik dhe vende të
5 tjera në komunën e Drenasit; Ferizaj dhe vende të tjera në
6 komunën e Ferizajt; Gjilan në komunën e Gjilanit; Jabllanicë
7 në komunën e Gjakovës; vende në komunën e Kaçanikut; Kleçkë
8 dhe vende të tjera në komunën e Lipjanit; Likoc dhe vende të
9 tjera në komunën e Skënderajt; Malishevë dhe vende të tjera në
10 komunën e Malishevës; në Shpellën e Volljakës në komunën e
11 Klinës; Novobërdë në komunën e Novobërdës; Zllash dhe vende të
12 tjera në komunën e Prishtinës; Prizren dhe vende të tjera në
13 komunën e Prizrenit; Suharekë dhe vende të tjera në komunën e
14 Suharekës; dhe vendndodhje në komunën e Vitisë; dhe

15 b. në Cahan dhe Kukës në Shqipërinë veriore.

16 3. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6 dhe 8, dhe 10 u kryen si
17 pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të
18 drejtuar kundër popullatës civile në Kosovë dhe Shqipëri
19 veriore, duke filluar prej së paku marsit '98 deri në shtator
20 '99. Në veçanti, këto krime kishin në shënjestër kundërshtarët
21 të cilët perceptoheshin se: (i) kishin bashkëpunuar, ose
22 kishin lidhje me forca, zyrtarë, ose institucione shtetërore
23 të Republikës Federale të Jugosllavisë, ose (ii) ndryshe, nuk
24 përkrahnin qëllimet dhe metodat e Ushtrisë Çlirimtare të
25 Kosovës, (UÇK), dhe më pas të Qeverisë së Përkohshme të

1 Kosovës, duke përfshirë edhe persona që kishin lidhje me
2 Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe persona të përkatësisë
3 etnike serbe, rome, dhe të tjera.

4 4. Krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen kundër personave
5 që nuk merrnin pjesë aktive në luftime, dhe në kontekstin e
6 dhe në lidhje me konfliktin e armatos jondërkombëtar në Kosovë
7 midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë,
8 ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore
9 dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe
10 grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë, nga
11 së paku marsi i vitit '98-të e deri më afërsisht 16 shtator
12 1999.

13 5. Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë
14 se z. Veseli është penalisht përgjegjës në bazë të nenit
15 16(1)(a) të Ligjit për:

16 a. kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
17 përbashkët, të krimeve në pikat 1 deri në 10, ose në
18 alternativë, kryerjen si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
19 përbashkët të lartpërmendur të krimeve në pikat 1 deri në 10,
20 duke qenë i vetëdijshëm se këto krime mund të kryheshin gjatë
21 zbatimit të qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të
22 përbashkët dhe duke e ndërmarrë këtë rrezik me vullnet të
23 lirë; dhe/ose

24 b. ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1 deri në
25 10.

1 6. Gjithashtu dhe në alternativë, ekziston dyshim i
2 bazuar mirë se z. Veseli është penalisht përgjegjës, në bazë
3 të nenit 16(1)(c) të Ligjit, si epror për krimet në pikat 1
4 deri në 10.

5 Ju faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

7 Sekretare.

8 Z. Veseli, dëshiroj t'ju kujtoj se kjo nuk është koha për
9 të kontestuar akuzat, por thjesht që të pranoni se i keni
10 kuptuar akuzat. Do të keni mundësi të bollshme që t'i
11 kundërshtoni akuzat me ndihmën e avokatit tuaj mbrojtës.

12 Z. Veseli, a i kuptuat akuzat që përmbahen në Aktakuzën e
13 Konfirmuar që i lexoi Sekretarja e Gjykatës?

14 I AKUZUARI VESELI: I nderuari Gjykatës, i dëgjova.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

16 Tani do t'ju informoj për të drejtat që keni para kësaj
17 Gjykate.

18 Ligji i Dhomave të Specializuara dhe Rregullorja e
19 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë një numër të drejtash.
20 Unë do t'i lexoj me zë disa nga më të rëndësishmet.

21 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e
22 fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm;

23 Në përcaktimin e akuzave kundër jush, ju keni të drejtën
24 për një gjykim të drejtë dhe publik në varësi të masave që
25 urdhërohen për mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve;

1 Keni të drejtën të informoheni menjëherë dhe në hollësi,
2 në një gjuhë që e kuptoni, për natyrën dhe arsyet e akuzave që
3 janë ngritur kundër jush;

4 Keni të drejtën që t'ju jepet kohë dhe mjete të
5 mjaftueshme për mbrojtjen tuaj -- për të përgatitur mbrojtjen
6 tuaj dhe të komunikoni me avokatin e zgjedhur prej jush;

7 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
8 arsyeshme;

9 Keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
10 mbronin veten përmes avokatit tuaj mbrojtës;

11 Keni të drejtën që t'ju caktohet gjykatës -- t'ju
12 caktohet avokat dhe pa pagesë në qoftë se nuk keni mjete të
13 mjaftueshme për të paguar për mbrojtjen;

14 Keni të drejtën t'i bëni pyetje, ose që dikush t'u bëjë
15 pyetje dëshmitarëve në emrin tuaj dhe të kërkonin paraqitjen
16 dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj;

17 Keni të drejtën e ndihmës pa pagesë nga një përkthyes, në
18 qoftë se nuk e kuptoni apo flisni gjuhën që përdoret në
19 Gjykatë;

20 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
21 vetes, ose të pranoni fajësinë;

22 Keni të drejtën të qëndroni në heshtje dhe nuk do të
23 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj;

24 Po kështu, keni të drejtën të bëni deklaratë pa betim në
25 lidhje me çështjen dhe mund të paraqiteni edhe si dëshmitar

1 nën betim;

2 Keni të drejtën të paraqisni mocione paraprake për të
3 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të
4 pretenduar të meta në formën e Aktakuzës dhe për të kërkuar
5 ndarjen më vete të Aktakuzës;

6 Keni të drejtën që 30 ditë nga data e seancës së sotme,
7 të kërkonit dhe të merrni materialet mbështetëse të Aktakuzës
8 së dorëzuar për konfirmim;

9 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e
10 dëshmitarëve që ka ndërmend të thërrasë Prokurori i
11 Specializuar për të dëshmuar në gjyq, në një gjuhë që ju e
12 kuptoni dhe e flisni, pra, në shqip;

13 Keni të drejtën që menjëherë të merrni çfarëdo
14 informacioni që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme
15 pafajësinë tuaj, ose të zbusë fajësinë tuaj, ose që ndikon në
16 besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar, sapo ky
17 informacion të jetë në ruajtjen, kontrollin ose dijeninë e
18 Prokurorit të Specializuar;

19 Keni të drejtën që i gjithë materiali dhe faktet që
20 zotëron Prokurori i Specializuar, t'ju vihen në dispozicion
21 përpara dhe gjatë procesit. Kjo e drejtë kufizohet vetëm nëse
22 është rreptësisht e nevojshme, ose kur zbatohen masa mbrojtëse
23 balancuese;

24 Keni të drejtën të mos mbaheni i paraburgosur për një
25 periudhë kohe të paarsyeshme para hapjes së çështjes

1 gjyqësore. Të kërkon rishqyrtimin e vendimeve për mbajtjen
2 tuaj në paraburgim dhe të bëni ankesë kundër këtyre vendimeve
3 para Gjykatës së Apelit;

4 Keni të drejtën të apeloni drejtpërsëdrejti para Gjykatës
5 së Apelit vendimet mbi mocionet paraprake që kundërshtojnë
6 juridiksionin e Dhomave të Specializuara;

7 Keni të drejtën që të kërkon leje për të apeluar vendime
8 të tjera.

9 Z. Veseli, i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që
10 gëzoni në përputhje me kornizën ligjore që zbatohet në Dhomat
11 e Specializuara. A i kuptoni këto të drejta?

12 I AKUZUARI VESELI: Po, i nderuar Gjykatës, i kuptoj.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 Gjithashtu dua t'ju informoj se në bazë të nenit 21(5) të
15 Ligjit, ju nuk mund të përfaqësoni veten sepse aktualisht jeni
16 në paraburgim. Pra, është i detyrueshëm përfaqësimi nga
17 Mbrojtësi i Specializuar.

18 Është detyra ime si Gjykatës i Procedurës Paraprake të
19 siguroj që e drejta juaj për të pasur avokat të respektohet.
20 Për këtë qëllim kam marrë shënim parashtrimin që ka bërë
21 Administratorja, që më informon për emërimin e mbrojtësit dhe
22 bashkëmbrojtësit.

23 Avokatët mbrojtjes, a mund të konfirmoni që ju jeni
24 emëruar për të përfaqësuar z. Veseli?

25 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] Po.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Pra, jam i bindur që i akuzuari është i përfaqësuar me
3 avokat mbrojtës.

4 Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të
5 vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, në
6 përputhje me rregullën 92.

7 Z. Veseli, brenda 30 ditësh nga data e sotme do të
8 ftoheni të pranoni fajësinë ose të vetëdeklaroheni i pafajshëm
9 për secilën aktakuzë në Aktakuzë -- për secilën akuzë në
10 Aktakuzën e Konfirmuar. Në qoftë se dëshironi mund ta bëni
11 menjëherë, pra, që të vetëdeklaroheni në lidhje me fajësinë
12 apo pafajësinë.

13 Pra, z. Veseli, desha t'ju pyes nëse keni pasur mundësinë
14 t'i diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatin
15 tuaj, dhe nëse jeni i gatshëm të vetëdeklaroheni tani? Në
16 qoftë se po, atëherë do t'ju kërkoja të çoheni në këmbë kur të
17 vetëdeklaroheni.

18 I AKUZUARI VESELI: Faleminderit i nderuar Gjykatës.

19 I dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e Aktakuzës.
20 Më lejoni të deklarohe me bindje të plotë se jam tërësisht i
21 pafajshëm në të gjitha pikat e Aktakuzës. Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Veseli.

23 Ishte shumë e qartë.

24 Tani të kaloj te gjuha e punës e kësaj procedure. Në
25 urdhrin për caktimin e datës për seancën e sotme, unë i

1 kërkoval palëve që të bëjnë parashtrime në lidhje me gjuhën e
2 punës në këtë çështje gjyqësore, sipas rregullës 8.

3 Z. Prokuror, ju i keni bërë parashtrimet tuaja më parë,
4 po për synime të kësaj seance.

5 Z. TIEGER: [Përkthim] Ne jemi dakord që gjuha e këtyre
6 procedurave të jetë anglishtja.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.
8 Avokati.

9 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] Nuk kemi
10 asnjë lloj kundërshtimi për këtë, sigurisht.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, unë do të lëshoj
12 një urdhër me kalimin e kohën në lidhje me këtë çështje.

13 Siç thuhet në urdhrin për këtë Paraqitje të Parë, unë do
14 të caktoj edhe datën e një Konferencë për Ecurinë e Çështjes,
15 në bazë të rregullës 96, e cila do të mbahet jo shumë vonë,
16 pra, jo shumë kohë pas paraqitjeve të para.

17 Qëllimi do të jetë shqyrtimi i ecurisë së çështjes, dhe
18 të organizohen shkëmbime midis palëve për të përgatitur sa më
19 shpejtë gjykimin.

20 Z. Veseli, dua t'ju kujtoj se keni të drejtën të merrni
21 pjesë në këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjen me avokatin
22 tuaj. Megjithatë, me pëlqimin tuaj me shkrim dhe pasi të jeni
23 këshilluar me avokatët tuaj mbrojtën, në bazë të rregullës
24 96(2), Konferenca për Ecurinë e Çështjes mund të ndiqet nga ju
25 personalisht, pra, me praninë tuaj fizike, ndërsa avokati mund

1 të marrë pjesë me videolidhje; nga avokati juaj, kurse ju
2 merrni pjesë me videolidhje; ose mund të bëhet në mungesën
3 tuaj z. Veseli, kurse avokati mund të marrë pjesë, ose të jetë
4 i pranishëm në sallë ose me videolidhje.

5 Tani do t'u kërkoj palëve të përcaktojmë një datë të
6 përshtatshme për Konferencën për Ecurinë e Çështjes, ose më
7 datë 18 nëntor, ose rreth asaj -- mbas asaj date.

8 Mbrojtja, a mund të na thotë nëse do të marrin pjesë me
9 videolidhje apo në person?

10 Z. TIEGER: [Përkthim] Për ne si Prokurori, ajo datë është
11 e përshtatshme.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuror.

13 Tani i kthehem Mbrojtjes.

14 [Probleme teknike]

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Edhe shikoj që kemi problem
16 me videolidhjen.

17 Znj. Sekretare e Gjykatës, a mund të lidheni me teknikën
18 për të parë nëse mund të rivendosim lidhjen?

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po shihet. Po trajtohet
20 kjo çështje, po shihet problemi nga kolegët.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të qëndrojmë në sallën e
22 gjyqit me shpresën që lidhja do të rivendoset shpejt.

23 [Gjykatësi i Procedurës Paraprake diskuton me
24 sekretaren e gjykatës]

25 Problemi po rregullohet. Desha t'i informoj palët edhe

1 brenda një minute ose dy minutash do të rivendoset lidhja,
2 kështu që shumë pak na duhet të presim.

3 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] A mundet --
4 më dëgjoni? Më falni për këtë -- oh, tani nuk ju shikoj unë. A
5 mund të --

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A na dëgjoni?

7 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] Ju dëgjoj, po
8 kam një problem me videolidhjen, me pamjen. A më dëgjoni?

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Videolidhja u shkëput
10 menjëherë para sesa unë do t'ju kërkoja të na jepni mendimin
11 tuaj për datën e Konferencës së Ecurisë së Çështjes.

12 E dëgjuat se çfarë tha Prokurori, apo dëshironi që ai ta
13 përsërisë atë që tha për datën?

14 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] E dëgjova
15 përgjigjen e z. Tieger dhe përgjigja ime në thelb është e
16 njëjtë, që edhe ne jemi në dispozicion të Gjykatës për datën
17 që është e volitshme për Gjykatën.

18 Ka mundësi që këto Konferencat për Ecurinë e Çështjen do
19 t'i kryejmë në të ardhmen e afërt me videolidhje.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, e morëm shënim.
21 Faleminderit shumë.

22 Do të merrni një urdhër për caktimin e datës që do të
23 ketë edhe rendin e ditës, me kalimin e kohës. Ju kërkoj palëve
24 që të paraqesin parashtrime me shkrim për temën e Konferencës
25 së Ecurisë së Çështjes.

1 Kam ndërmend të caktoj datën për parashtime me shkrim
2 për Prokurorinë të premtën 13 nëntor, ndërsa për Mbrojtjen të
3 martën më 17 nëntor, dhe pas Konferencës për Ecurinë e
4 Çështjes do të jap një vendim në lidhje me detyrimet e
5 nxjerrjes së materialeve nga Prokurori i Specializuar, në
6 përputhje me rregullën 102, si dhe për regjimin e redaktimeve
7 për këto procedura.

8 Tani dua t'u kërkoj palëve të thonë nëse kanë ndonjë
9 çështje që duan të ngrenë, dhe u kujtoj palëve që të na
10 njoftojnë paraprakisht në qoftë se ndonjë nga këto parashtime
11 që kanë të bëjnë me nxjerrjen e materialeve konfidenciale, të
12 na thuhet paraprakisht, pra, në mënyrë që të merren masat e
13 duhura.

14 Z. TIEGER: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

15 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] A mund të
16 ngre nja dy çështje shumë shkurtimisht?

17 Së pari, faleminderit që ritheksuat zbatimin e parimin të
18 prezumimit të pafajësinë në këto procedura, dhe dua të kujtoj
19 që z. Veseli duhet të presupozohet, apo të prezumohet i
20 pafajshëm për të gjitha akuzat dhe për të gjitha qëllimet kur
21 të vazhdojë çështja.

22 Po kështu dhe duke vijuar nga kjo, Gjykata do të marrë
23 një parashtim ose kërkesë që z. Veseli të lirohet deri në
24 pritje të fillimit të gjykimit.

25 Pika e tretë. Desha që të shënohet në procesverbal fakti,

1 që ndonëse është përmendur fakti që z. Veseli është arrestuar,
2 ju si Gjykatës dhe publiku duhet të dini që z. Veseli erdhi
3 këtu në Gjykatë në bazë të një marrëveshjeje për të ardhur
4 vullnetarisht që e kishte me Prokurorinë, dhe që u bë kjo
5 marrëveshje paraprakisht; dhe dorëzimi i tij në mënyrë
6 vullnetare u bë përmes avokatit.

7 Dhe së katërti dhe pika e fundit është në lidhje me
8 pozicionin e z. Veseli në lidhje me këto procedura. Dhe mendoj
9 që është e drejtë ta theksoj këtë; që në ditën që ai u
10 dorëzua, ai ka dorëzuar një deklaratë që unë dua ta lexoj për
11 procesverbalin, një pjesë të tij. Pra:

12 "Kam besim në objektivitetin dhe drejtësinë e gjykatësve
13 dhe unë u kërkoj të gjithëve në Kosovë që të tregojnë
14 respektin e duhur për autoritetin gjyqësor në të gjitha kohët.
15 Procesi është atje për të gjetur të vërtetën dhe nuk kemi
16 asgjë për të pasur frikë nga e vërteta. Nuk duhen të bëhen
17 përpjekje për minimin e punës së Tribunalit, apo për të
18 penguar apo ndërhyrë në proces. Ne duhet të lejojmë që këto
19 detyra të rëndësishme të kryhen dhe integriteti i procesit
20 duhet të respektohet nga të gjitha -- nga të gjithë në të
21 gjitha kohët. Drejtësia nuk i shërben vetëm interesave të
22 njërës palë apo një pale tjetër, ajo i shërben interesave të
23 popullit. Pra, në qoftë se ju kërkohet të ndihmoni Dhomat e
24 Specializuara bëjeni këtë pa hezitim dhe do t'u kërkoj -- në
25 këtë mënyrë do të arrijmë tek e vërteta. Pra, do të kërkoj që

1 të gjitha seksionet e shoqërisë tonë t'i përgjigjen kësaj
2 situatë me qetësi dhe me dinjitet, me besim në dijeninë se
3 gjykatësit do të japin vendimin e drejtë në fund. Ju lutem,
4 mbani mend në të gjitha kohërat, se ky Tribunal është ngritur
5 nga Parlamenti i Kosovës që vepron në emër të popullit dhe
6 është mishërim i parimit, që nuk ka paqe pa drejtësi dhe nuk
7 ka drejtësi pa paqe. Megjithëse është në Hagë, kjo Gjykatë
8 është pjesë e ligjit tonë. Kjo nuk -- nuk duhet të kemi asnjë
9 lloj mërie ndaj ndërkombëtarëve që punojnë në këtë Tribunal.
10 Ata aty po bëjnë atë që ne populli i Kosovës i kemi kërkuar të
11 bëjnë. Ky Tribunal është pjesë e rrugëtimit të Kosovës drejt
12 krijimit të shtetit, drejt forcimit të shtetit dhe ne duhet ta
13 çojmë këtë proces deri në fund."

14 Z. Veseli më kërkoi që ta lexoj unë këtë në emër të tij.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

16 Z. Prokuror, dëshironi të shtoni ndonjë gjë?

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Sigurisht Prokuroria i mirëpret në
18 të gjitha kohët të vërtetat që janë të vetëkuptueshme, siç i
19 tha edhe z. Emmerson në emër të z. Veseli. Nuk kam asgjë
20 tjetër për të shtuar në këtë moment.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit Prokuror.

22 Z. Emmerson, keni diçka për të shtuar?

23 Z. EMMERSON: [përmes videolidhjes/përkthim] Jo,
24 faleminderit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Veseli, desha t'ju pyes nëse keni ju ndonjë çështje
2 për të ngritur në lidhje me arrestim tuaj, transferimin tuaj
3 apo mbajtjen në paraburgim?

4 I AKUZUARI VESELI: Jo, nuk kam asgjë tjetër t'i shtoj
5 deklaratës së avokatit tim. Faleminderit i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
7 Veseli.

8 Së fundi, ju informoj që unë do të nxjerr një vendim ku
9 do ta urdhëroj Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe
10 Administratoren që t'i riklasifikojë këto parashtrimet e tyre,
11 ose të përgatisë versione të redaktuara, në mënyrë që Mbrojtja
12 t'i ketë sa më shpejt që të jetë e mundur ato.

13 Duke qenë se jeni në paraburgim z. Veseli, dua t'ju
14 informoj që ju mund ta kundërshtoni mbajtjen tuaj në
15 paraburgim, në përputhje me rregullën 57. Kjo do të bëhet me
16 vendime me shkrim.

17 Me kaq mbyllet seanca e sotme. I falënderoj palët dhe
18 Zyrën Administrative që morën pjesë në të. I falënderoj
19 përkthyesit, stenografët, teknikët për ndihmën e tyre.

20 Seanca mbyllet.

21 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në orën 15.40

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore
Paraqitja e Parë (Seancë e hapur)

Faqe 22

1

2

3

4